



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2227928

Nr. 1752 Prot.  
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 06 . 12 .2010

**Lënda:** Dërgohet "Raporti i punës për muajin Nëntor 2010"

**Drejtuar:** **Z. BUJAR NISHANI**  
**MINISTËR I DREJTËSISË**

**TIRANË**

**I nderuar Z. Ministër!**

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", bashkëlidhur po Ju dërgojmë Raportin mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për muajin Nëntor 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

Konceptoi: Saimir Shyti  
Datë 06.12.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

R A P O R T  
PËR MUAJIN NËNTOR 2010

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për muajin Nëntor 2010.

## I. Statistika

Për periudhën 01-31 Nëntor 2010, volumi i punës së kryer nga Shërbimi i Provës ka qenë i madh, duke marrë parasysh faktin që megjithë hapjen e 4 Zyrave të reja Vendore, numri i specialistëve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialistë mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga gjykatat dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

Për periudhën 01 Qershor 2009 - 31 Nëntor 2010, statistikat rezultojnë si më poshtë:

### *1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative të dhëna nga gjykatat.*

Numri total i të dënuarve me dënime alternative që janë mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, për periudhën 01.06.2009 - 30.11.2010, është 2371 të dënuar.

Nga 01.06.2009 deri më datë 30.11.2010, kanë përfunduar periudhën e provës nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës 172 të dënuar, pra ka përfunduar me sukses procesi i mbikëqyrjes për ta.

Në zbatim të Urdhërit Tuaj nr. 7746/1, datë 24/09/2010, "Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës" dhe Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Provës, nr. 1316, datë 08.10.2010, "Për marrjen në dorëzim të dosjeve të mbikëqyrjes nga Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, sipas kompetencave tokësore të tyre", u krye me sukses dorëzimi i bazës materiale nga zyrat e vjetra, në ato të reja, sipas kompetencave tokësore të tyre dhe rezultoi kjo ngarkesë pune për Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës:

Kështu numri total i të dënuarve që ndodhen aktualisht nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës (duke zbritur numrin e atyre që kanë përfunduar dënimin alternativ) është **2199 të dënuar**.

I ndarë sipas Zyrave Vendore (duke llogaritur dhe të dënuarit që kanë përfunduar dënimin alternativ):

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **932** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **204** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **355** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **312** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Lezhë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **118** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Elbasan mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **109** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Korçë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **139** të dënuar me dënime alternative.
  - Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Gjirokastrë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës **30** të dënuar me dënime alternative.

**2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.**

Sa më sipër duke ju referuar numrit total të të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës prej **2199** të dënuarish, numri mesatar i të dënuarve që mbikëqyren nga një punonjës në nivel

vendi aktualisht është 73. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje 93 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje 68 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje 59 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje 104 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Lezhë ka nën mbikëqyrje 39 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Elbasan ka nën mbikëqyrje 55 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Korçë ka nën mbikëqyrje 70 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Gjorokastër ka nën mbikëqyrje 30 të dënuar për çdo punonjës.

Duke ju referuar statistikave, gjatë muajit Nëntor 2010 kanë përfunduar periudhën e mbikëqyrjes 25 të dënuar. Shtesa për muajin Nëntor 2010 (nga 01.09.2010 - 30.11.2010), prej 163 të dënuarish nën mbikëqyrje, rrit dhe ngarkesën e punës për specialistët.

### 3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ.

Statistikat për periudhën 01.06.2009 - 30.11.2010, për secilin lloj dënimi alternativ, për të dënuarit e mbikëqyrur nga Shërbimi i Provës, janë si më poshtë:

- 1861 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP "pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë", shifër kjo e barabartë me 78.49 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 41 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP "qëndrim në shtëpi", shifër kjo e barabartë me 1.73 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

- 273 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP "Lirim me kusht", shifër kjo e barabartë me 11.51 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 196 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP "Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik", shifër kjo e barabartë me 8.27 % të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- asnjë person nuk është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP "gjysëm-liria".

Këto të dhëna pasqyrohen më poshtë, në Tabelën 2.

**Tabela 2: Numri i të dënuarëve sipas llojeve të dënimeve alternative të dhëna nga Gjykata për periudhën 01.06.2009 – 31.10.2010.**

Nr	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE	Nr. TOTAL	TOTALI në %
1	Pezullimi ... neni 59 i KP	1861	78.49%
2	Qëndrimi në shtëpi neni 59/a i KP	41	1.73%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	273	11.51%
4	Punë në interes publik neni 63 i KP	196	8.27%
5	Gjysmëliria neni 58 i KP	0	0%
<b>TOTALI</b>		<b>2371</b>	<b>100%</b>

Për periudhën 01.06.2009 – 30.11.2010 numri i të dënuarve me "punë në interes publik" është 196, ndërsa pas përfundimit të këtij dënimi për 108 të dënuar, Shërbimi i Provës ka nën mbikëqyrje 88 të dënuar.

#### **4. Raportet e Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.**

Konkretisht për muajin Nëntor 2010:

- ❖ Janë kërkuar nga gjykatat 55 raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ Janë kërkuar nga prokuroritë 42 raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,

❖ Kanë ardhur 163 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 32 urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikqyrjes për ta.

Ndërsa në total volumi i punës së Shërbimit të Provës për periudhën 01.06.2009 - 30.11.2010 jepet si më poshtë:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata 1083 raporte vlerësimi për persona të pandehur dhe të dënuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokuroritë 433 raporte vlerësimi për persona nën hetim dhe të pandehur,
- ❖ Kanë ardhur 2371 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 355 urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikqyrjes për ta.
- ❖ Ka përfunduar procesi i mbikqyrjes për 172 të dënuar.

## II. Bashkëpunimi me partnerët

- me OSBE dhe UNICEF.

Në data t 1-5 Nëntor 2010, në ambjentet e OSBE-së, nën mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, u zhvillua një Trajnim për Shërbimin e Provës, për punonjësit e Zyrave të reja Vendore të Shërbimit të Provës, me lektorë të huaj dhe vendas. Ky ishte një trajnim i zgjeruar për stafin e ri, me pjesëmarrjen e rreth 20 pjesëmarrësve nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës. Tashmë stafi i këtyre zyrave është i përgatitur të realizojë detyrat funksionale të tij të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

Në ZVSHP Lezhë është zhvilluar një takim me shefin e Zyrës OSBE-së Shkodër dhe asistenten e tij. Gjatë takimit, u shpreh gatishmëria për çfarëdo lloj ndihme apo mbështetje juridike në shërbim të ZVSHP Lezhë, si dhe u njohën me ambientet e zyrave të Shërbimit të Provës.

**- me Ojf-të.**

Nën organizimin e Shoqatës Aksion Plus në bashkëpunim me ZVSHP-të Durrës dhe Shkodër u organizuan dy takime informuese për shërbimet që ofrohen nga disa OJF, në kuadër të zbatimit të Alternativave të dënimit me burgim, në këto qytete.

Në takim morën pjesë, përfaqësues të OJF-ve, gjyqtarë, prokurorë, psikologë, përfaqësues të ZVSHP-ve, Durrës dhe Shkodër, mjekë, etj.

Për gjyqatrët dhe prokurorët u sqarua se si Shërbimi i Provës trajton raste të veçanta të dënuarish, në përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata dhe kryesisht të denuarit përdorues droge. Gjyqtarët dhe prokurorët u informuan për mënyrën e bashkëpunimit të Shërbimit të Provës me këto OJF, dhe se si adresohen këta të dënuar në këto OJF, nëpërmjet letër referencave, bazuar në memorandumet e bashkëpunimit.

Informacioni i dhënë nga shoqata Aksion Plus ishte shumë i vlefshëm për pjesëmarrësit, të cilët treguan interes, veçanërisht për programet e trajtimit me metadon dhe programin e menaxhimit të agresivitetit.

Gjithashtu kjo shoqatë zhvilloi një takim informues me studentë të degës juridik të Universitetit Luarasi, në Tiranë, në muajin nëntor, lidhur me çështjet e sipërpërmendura. Në takim morën pjesë dhe përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme.

Vlen të theksohet se gjatë takimeve të sipërcituara, të zhvilluara në të tre qytetet, u vlerësua bashkëpunimi me Shërbimin e Provës nga ana e organizatave, prokurorëve, gjyqtarëve dhe nuk u paraqit ndonjë problematikë.

**- me pushtetin vendor.**

Për sa i përket bashkëpunimit me pushtetin vendor, përveç 45 memorandumëve të bashkëpunimit që kemi pasur nënshkruar më parë [me 4 Këshilla Qarqesh, 21 Bashki (nga të cilat 4 Njësi Bashkiake) dhe 20 Komuna], për të cilat ju kemi bërë me dije në raportet e mëparshme, në muajin nëntor janë nënshkruar edhe këto memorandume me njësitë e qeverisjes vendore dhe konkretisht:

- |                            |                              |
|----------------------------|------------------------------|
| 1. Këshilli i Qarkut Korçë | 12. Komuna Vreshtas / Korçë  |
| 2. Bashkia / Korçë         | 13. Komuna Voskopojë / Korçë |
| 3. Bashkia Bilisht         | 14. Komuna Gorë / Korçë      |



- |                            |                                 |
|----------------------------|---------------------------------|
| 4. Komuna Pojan / Korçë    | 15. Komuna Buçimas / Pogradec   |
| 5. Komuna Liqenas / Korçë  | 16. Komuna Dardhas / Pogradec   |
| 6. Komuna Drenovë / Korçë  | 17. Komuna Hudenisht / Pogradec |
| 7. Komuna Mollaj / Korçë   | 18. Komuna Proptisht / Pogradec |
| 8. Komuna Liqenas / Korçë  | 19. Komuna Çerravë / Pogradec   |
| 9. Komuna Bulgarec / Korçë | 20. Komuna Miras / Devoll       |
| 10. Komuna Pirg / Korçë    | 21. Komuna Progër / Devoll      |
| 11. Komuna Voskop / Korçë  | 22. Komuna Q.Bilisht / Devoll   |

Pra në total kemi nënshkruar 66 memorandume bashkëpunimi midis Shërbimit të Provës dhe organeve të qeverisjes vendore dhe konkretisht me 5 Këshilla Qarqesh, 23 Bashki (nga të cilat 4 Njësi Bashkiake) dhe 38 Komuna. Ndërkohë që vazhdon puna dhe korespondenca për nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit edhe me bashkitë dhe komunitat e tjera.

### III.-Problematika e punës.

#### 1.- Zyrat e reja Vendore dhe ngarkesa.

Gjatë muajit Nëntor kemi vazhduar me intensitet menaxhimin e punëve për sigurimin e ambjenteve të punës për zyrat e reja vendore që u hapën me vendodhje në rrethet gjyqësore Lezhë, Korçë, Elbasan, Gjirokastrë.

Problemi kryesor del hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje në të gjitha rrethet gjyqësore ku nuk janë ngritur ende, si dhe shtimi i organikës së Shërbimit të Provës, me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji dhe arritjen e standardeve të parashikuara në Strategjinë Sektoriale të Drejtësisë dhe SKZHI-së, për Shërbimin e Provës, ku një nga indikatorët është dhe raporti i numrit të dënuarve që mbikqyren mesatarisht për një specialist të Shërbimit të Provës, përkatësisht 35 të dënuar /specialist.

Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbiëkqyrje nga institucioni ynë 2199 të dënuar, ose mesatarisht 73 të dënuar për çdo specialist, numër i

cili vazhdon të rritet, dhe që është më i lartë se standartet e vendeve europiane, pa shtuar këtu faktin se punonjësit tanë deri më tani kanë hartuar mesatarisht edhe **50 raporte vlerësimi për specialist**, sipas kërkesave të gjykatave dhe prokurorive, gjë që e bën të papërballueshme ngarkesën e punës.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë që pasqyron me objektivitet punën e kryer, si dhe një paraqitje të problematikës themelore nga Shërbimi i Provës, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

